

VENDIM I ORTAKËVE
TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BLUE TDI SH.P.K.

BLUE TDI Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (“**QKB**”), me NUIS L91926023K dhe me seli në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nr. 6, Kati i I, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë, (këtu e më poshtë referuar si “**Shoqëria**”).

Vendi i Mbledhjes: Tiranë, Shqipëri

Data e Mbledhjes: 21.12.2020

Nr i vendimit: 2

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, si më poshtë:

- Ortaku, Shoqëria **Matrix Konstruksion Sh.p.k.** zotërues i 32.50 % (tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Shoqëria perfaqesohet ne mbledhje nga Znj.Ida MEZINI
- Ortaku, Shoqëria **GBI Sh.p.k.** zotërues i 22.50% (njëzet e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitali. Ne kete mbledhje perfaqesohet nga Z. Hajredin DIBRA
- Ortaku, Shoqëria **WSI Sh.p.k.** zotërues i 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (nje) pjesë e kapitali. Ne kete mbledhje perfaqesohet nga Z.Bledar SINANI

Rendi i ditës:

- Miratimi i raportit të audituesit ligjor lidhur me zmadhimin e kapitalit të regjistruar.
- Miratimi i zmadhimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë.
- Të Ndryshme.

MEQËNËSE:

- A. **BLUE TDI Sh.p.k.**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me kapital të zotëruar nga ortakët e shoqërisë.
- B. Në përputhje me Nenin 6, paragrafi 6.1, të Statutit të Shoqërisë, kanë filluar procedurat për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë, nga vlera aktuale prej 100.00 (njëqind) lekë në **225,859,743** (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë.
- C. Sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë datë 02.12.2020, shoqëria I.L.D.-99 Audit sh.p.k me nipt K31516110I me seli në adresën Rr. “Emin Duraku”, Pall. Aviacioni i Vjetër, Shk. 6, Ap. 66, Tiranë, Shqipëri, përfaqesuar nga administratori Z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelenë, Shqipëri, banues në Rr. “Komuna e Parisit”, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i licensës së Audituesit Ligjor Nr. 40, datë 10.02.2000 është caktuar me detyrën e përgatitjes së raportit

mbi zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nga vlera aktuale prej 100.00 (njëqind) lekë në **225,859,743** (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë.

- D. Në përputhje me Nenin 9, paragrafi 9.2, pika c të Statutit, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë merr vendimin për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- E. Janë plotësuar të gjitha kushtet për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë, e cila është thirrur dhe organizohet në përputhje me Statutin dhe Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**").

PËR SA MË SIPËR, Ortakët e Shoqërisë, VENDOSËN:

- I. **Miratimin e Raportit** – Të miratojnë Raportin për zmadhimin e kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë të hartuar nga audituesi ligjor I.L.D.-99 Audit sh.p.k.
- II. **Miratimin e zmadhimit të kapitalit të regjistruar** - Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga vlera aktuale prej 100.00 (njëqind) lekë në **225,859,743** (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë.
- Të miratojnë rregullisht ndryshimin e Statutit të Shoqërisë, në pjesën e kapitalit themeltar i cili riformulohet si më poshtë: Kapitali themeltar i shoqërisë nga 100 (njëqind) lekë rritet edhe me 225,859,643 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzetë e tre) lekë dhe bëhet 225,859,743 (dyqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre) lekë.
 - Kapitali është i ndarë në 3 kuota.
 - Ortakët zotërojnë pjesë të kapitalit të Shoqërisë si në vijim:
 - Ortaku, Shoqëria **Matrix Konstruksion Sh.p.k.** zotëron 1 kuotë, e barabartë me 32.50 % (tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë 73,404,416.5 (shtatëdhjetë e tre milion e katërqind e katër mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë e 50/100) **lekë**.
 - Ortaku, Shoqëria **GBI Sh.p.k.** zotëron 1 kuotë, e barabartë me 22.50% (njëzet e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë 50,818,442.5 (pesëdhjetë milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e dy e 50/100) **lekë**.
 - Ortaku, Shoqëria **WSI Sh.p.k.** zotëron 1 kuotë, e barabartë me 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë 101,636,884 (njëqind e një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) **lekë**.
- III. **Të autorizojnë** Administratorin e Shoqërisë, Zj. Ana Lleshi në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin për llogari të Shoqërisë të çdo dokumenti të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi dhe në përgjithësi të kryejë të gjithë veprimet e duhura për kompletimin e tij dhe të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri në marrjen e ekstraktit përkatës që vërteton kryerjen e këtyre veprimeve për të cilat autorizohet.

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, përbërë nga Ortakët e Shoqërisë, që u mbajt sot më 21.12.2020 dhe që u mbyll në orën 10:00, nuk u mor asnjë vendim tjetër.

ORTAKËT E SHOQËRISË

WSI Shpk.

Bledar Sinani
Bledar SINANI

Matrix Konstruksion Shpk.

Ida Mezin
Ida MEZINI



GBI Shpk.

Hajredin Dibra
Hajredin DIBRA

